



Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) në bashkëpunim me Këshillin e Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF) në kuadër të nismës “Institucionalizimi i shërbimeve cilësore të rehabilitimit dhe integritetit për të mbijetuarit e dhunës” i financuar nga Agjencioni Austriak për Zhvillim, shpall:

THIRRJE PËR APLIKIM PËR TRAJNIMIN PËR TRAJNER

Ftohen të aplikojnë të interesuarit të cilët kanë njohuri dhe përvojë nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare, dhe/ose adresimeve të dhunës me bazë gjinore, për të ndjekur një trajnim për t'u bërë trajnerë të dy moduleve:

- I. “Puna me viktimat e dhunës në familje, trajtimi dhe referimi”
- II. “Puna me viktima të krimeve seksuale dhe trafikimit”

Trajnimet do të përfshijnë pjesën teorike dhe praktike për menaxhimin e rasteve në punë, aplikim të shkathtësive këshilluese dhe teknikat për trajtim dhe referim të personave që kanë përjetuar dhunë në familje apo që janë viktima të krimeve seksuale dhe të trafikimit me qenie njerëzore, bazuar në kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare. Modulet pritet të përdoren si një mjet për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të mbrojtjes sociale nga sektori publik dhe joqeveritar në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes, rehabilitimit dhe reintegritetit të viktimave të dhunës në familje dhe të krimeve seksuale e të trafikimit.

Në fund të procesit, pritet që kandidatët të jenë në gjendje të mbajnë vetë trajnimet për këto module për profesionistët e shërbimeve sociale në të gjithë Kosovën, duke përdorur materialet e ofruara nga ky trajnim hyrës i trajnerëve. Kandidatët duhet të kalojnë një provim, pas të cilit do të jenë trajnerë të certifikuar zyrtarisht për këto module nga KPSHSF.

Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së programit të trajnimit

Programi i trajnimit për trajnerë do të zgjasë katër (4) ditë dhe është i ndarë në dy pjesë sipas moduleve të përcaktuara. Moduli i parë: *Puna me viktimat e dhunës në familje trajtimi dhe referimi*, do të zgjasë dy (2) ditë dhe tentativisht do të mbahet në datat **1-2 Nëntor 2022**. Moduli i dytë: *Puna me viktimat e krimeve seksuale dhe trafikimit*, do të zgjasë dy (2) ditë dhe tentativisht do të mbahet në datat **10-11 Nëntor 2022**. Trajnerët duhet të marrin pjesë në të gjitha sesionet për t'u certifikuar si trajner në modulën përkatës.

Aplikacionet vlerësohen në bazë të kriterëve si në vijim:

Numri i kandidatëve që do të përzgjidhen për të vijuar trajnimin është i limituar.

- Arsimimi dhe kualifikimi profesional në Punë Sociale, Psikologji, Juridik, dhe/ose Sociologji, minimumi i kualifikimit Bachelor;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale dhe/ose trajtimin e dhunës me bazë gjinore; dhe
- Përvoja në ofrimin e trajnimeve do të jetë përparësi.

Procesi i aplikimit

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve është: **25.10.2022 në orën 18:00**. Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm CV dhe një **letër motivimi përmes së cilës** kandidati shpjegon se si i plotëson kriteret dhe motivimin e tyre për t'u bërë trajner (deri në **250 fjalë**) në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe, në e-mail adresën: kosovawomensnetwork@gmail.com. Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në CV tuaj mund të kërkojnë për verifikim. Kandidatët do të zgjidhen në bazë të kriterëve të lartpërmendura nga një Komision Përzgjedhës i përbërë nga stafi i RrGK dhe KPSHSF-së. Personat e përzgjedhur do të njoftohen tentativisht brenda datës **28 Tetor 2022**.

With funding from



Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare
Generalni Savet Socijalnih i Porodičnih Usluga
General Council of Social and Family Services



With funding from